

Foka e Mesdheut

Jeta midis tokës dhe detit



Shpërndarja e Fokës së Mesdheut


(*Monachus monachus*)

Një nga fokat më të rralla në botë, Foka e Mesdheut, dikur popullonte gjithë Mesdheun dhe Detin e Zi, duke u shtrirë deri në Oqeanin Atlantik përgjatë vijës bregdetare verilindore të Afrikës. Shtrirja e saj përfshinte arkipelagët e Makronezisë, si Azoret, Madeira, Ishujt Kanarie dhe Kepi i Gjelbër dhe arrinte deri në jug, në brigjet e Senegalit dhe Gambias.

Sot, kanë mbetur afërsisht **1,000 individë**, gjysma e të cilëve jetojnë në pellgun lindor të Mesdheut. Megjithatë, vëzhgimet gjithnjë e më të shpeshta në të gjithë detin Adriatik, së bashku me numrin në rritje të individëve nga popullatat kryesore, tregojnë një rimëkëmbje të mundshme. Në Listën e Kuqe të Specieve të Kërcënuara të IUCN-së, Foka e Mesdheut është e listuar si Vulnerabël (VU).

© Ugo Mellone





© Ugo Mellone

Ku ndodhen tani?

Aktualisht, Fokat e Mesdheut mund të gjendet në:



Mesdhe:

Greqi, Turqi, Qipro



Atlantik:


Madeira (Portugali), Cabo Blanco (Mauritani/Sahara Perëndimore)



Popullatat riprodhuese aktuale



Vendet dhe rajonet ku janë raportuar vëzhgime që nga viti 2000



Vëzhgimet në rritje në Shqipëri, Mal të Zi, Kroaci dhe Itali japin shpresë për rimëkëmbjen e këtij lloji në Adriatik!

Si është pamja e tyre?




 ~1 m

Këlysh i Fokës së Mesdheut

Ushqyerja me gji e të vegjëlve ndërpritet plotësisht kur ata janë 4 muajsh, kanë ngjyrë të hirtë në pjesën kurrizore dhe të bardhë në pjesën e barkut.



 ~ 2 - 2,4 m

Mashkull i rritur

Meshkujt marrin ngjyrë të zezë kur matorohen, ndërsa njolla e barkut bëhet sërish e dukshme.

I porsalinduri i Fokës së Mesdheut

Lindin me gëzof të zi (i mbuluar me push) me një njollë të bardhë në pjesën e barkut.



 ~ 1,5 m

Femër e rritur

Fokat ndryshojnë pjesërisht pamjen e tyre çdo vit. Sidoqoftë, gërvishtjet e mëdha që përdoren për identifikim zakonisht mbeten të dukshme në trupin e fokave.



 ~ 2,4 m

Habitati dhe Dieta

Fokat e Mesdheut preferojnë shpellat detare me plazhe të izoluar për të pushuar, çiftuar dhe riprodhuar. Këto shpella ofrojnë mbrojtje nga njerëzit dhe grabitqarët dhe si rrjedhojë janë kritike për mbijetesën e llojit.

Fokat janë grabitqarë që qëndrojnë në krye të zinxhirit ushqimor dhe ushqehen me peshq, cefalopodë dhe krustace (peshqit e familjes Sparidae dhe oktapodët përbëjnë dietën kryesore të tyre).



Dieta ushqimore:



Karkaleca



Oktapodë



Peshq



Kallamarë

Kërcënimet kryesore



Kapja aksidentale në rrjetat e peshkimit dhe metodat ilegale të peshkimit (p.sh. eksplozivët)



Mbipeshkimi i cili zvogëlon bazën ushqimore



Shtimi pa kriter i aktiviteteve njerëzore përgjatë vijës bregdetare

Ndotja



Rritja e turizmit dhe trafikut detar

Si mund të ndihmoni

Ndihmoni në mbrojtjen e detit: shpallni dhe mbështesni zonat e mbrojtura detare, reduktoni ndotjen dhe respektoni habitatin e fokave.

Raportoni vëzhgimin e fokës tek partnerët e projektit në vendin tuaj, agjencitë shtetërore, OJF-të ose veterinerët. Mbani shënim vendodhjen e saktë, datën dhe orën e vëzhgimit. Përpiquni të mblidhni sa më shumë informacion të jetë e mundur në lidhje me pamjen dhe sjelljen e fokës; numrin e individëve, ngjyrën, gjatësinë e trupit dhe nëse është duke gjuajtur, pushuar, notuar, zhytur etj.

Qëndroni larg! Mos ndërveproni apo shqetësoni fokën dhe nxisini të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. Mbajini kafshët shtëpiake larg fokave.

Bëni një foto ose video nëse është e mundur – kjo ndihmon shumë në identifikimin e individëve. Megjithatë, mbani një distancë të sigurtë për të shmangur shqetësimin e gjallesës.

Mos harroni: Fokat e Mesdheut janë kafshë të egra me nofulla të forta dhe dhëmbë të mëdhenj- ato nuk janë kafshë shtëpiake. Kurrë mos tentoni t'u afroheni apo ti prekni.

© Mareo Colombo



© Bruno D'Amicis



A e dini se?

Është një prej tre llojeve të fokave që jetojnë në ujëra të ngrohta. Llojet e tjera janë Foka Havajane dhe Foka Karaibjane, e cila u deklarua e zhdukur më 1950 si rezultat i gjuetisë dhe shfrytëzimit intensiv nga njeriu.

Në vitin 1997, një ngjarje masive vdekshmërie goditi koloninë më të madhe të njohur të Fokave të Mesdheut në Cabo Blanco (Mauritani/Sahara Perëndimore). Popullata ra ndjeshëm nga 350 në 150 individë, duke e çuar specien më pranë zhdukjes.

Fokat e Mesdheut mund të flenë duke qëndruar pezull në ujë dhe duke nxjerrë vetëm hundën në sipërfaqe për të marrë frymë. Kjo i lejon të pushojnë në det të hapur.

Fokat e Mesdheut janë notare të forta dhe aktive. Ato mund të notojnë deri në 40 kilometra në ditë.

Fokat e Mesdheut janë njohur që në lashtësi—Ato shfaqen në vizatime parahistorike në shpella, si dhe në mozaikët dhe shkrimet Greke dhe Romake.

Punojmë së bashku për një të Ardhme: Projekti për Fokën e Mesdheut në Adriatik

Kthimi i fokave të Mesdheut në Adriatik është i mundur vetëm përmes përforsimit të bashkëpunimit.

Organizatat mjedisore nga Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia dhe Italia janë duke punuar së bashku për të mbrojtur këtë lloj dhe habitatet e saj bregdetare. Duke shkëmbyer njohuritë, forcuar kapacitetet lokale dhe duke adresuar kërcënimet, si shqetësimi njerëzor dhe shkatërrimi i habitatit, po krijojmë kushtet e nevojshme për kthimin e fokave të Mesdheut.

Por kjo nuk është diçka që mund të realizohet vetëm. Komuniteti i peshkimit, turizmit dhe palët e tjera të interesuara për mbrojtjen e natyrës luajnë një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e Fokës së Mesdheut. Me përpjekje të përbashkëta, të vazhdueshme dhe mbështetje të duhur, mund të ndihmojmë Fokën e Mesdheut nga pragu i zhdukjes.

© Bruno D'Amicis

**Mëso më shumë
rreth llojit dhe
Projektit për
Fokën e Mesdheut
të Adriatikut këtu:**



**Adriatic
Monk Seal
Project**



Archipelagos



ambiente
e sviluppo
environment
and development



CZIP



UDRUGA / ASSOCIATION



FLAG PINE
Environmental Organization



Mediterranean Center for
Environmental Monitoring
**Med
CEM**
Mediterranski Centar
za Ekološki Monitoring



PPNEA
PROTECTION AND PRESERVATION OF NATURAL ENVIRONMENT IN ALBANIA
SINCE 1991

*Koordinuar
nga:*

EURONATUR

*Mbështetur
nga:*



**MONK
SEAL
ALLIANCE**